



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Pukë, më 22/08/2025

Nr. 1628/2025

Lënda: Kërkim përgjigje
Drejtuar: ZNJ. OLA MITRE
Adresa: Ish-Kinostudio, TV SCAN, TIRANË

Në përgjigje të kërkesës për informacion, drejtuar Bashkisë Pukë, informojmë si më poshtë:

1. - Cilat janë zonat prioritare të zhvillimit në bashkinë tuaj, të shpallura sipas ligjit "Për paketën e maleve"?
 - Zonat prioritare të zhvillimit në Bashkinë Pukë janë të shpallura në Planin e Përgjithshëm Vendor, i cili mund të aksesohet lehtësisht për çdo të inetersuar në web-in e Bashkisë Pukë www.bashkiapuke.gov.al në linkun: <https://bashkiapuke.gov.al/miratohet-plani-i-pergjithshem-vendor-i-bashkise-puke/>
2. - Të vendoset në dispozicion relacioni shoqërues i projektaktit për shpalljen e këtyre zonave, i parashikuar në udhëzimin Nr.1, datë 19.6.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive".
 - Projektvendimi për shpalljen e zonave, sipas parashimeve të udhëzimit të mësipërm, do të kalojë për miratim në këshillin e Bashkisë Pukë mbledhjen e radhës që do të zhvillohet javën e parë të shtatorit 2025.
3. - Sa është numri i kërkesave të mbërritura nga qytetarët për të shprehur interes për identifikimin e zonave zhvillimore për Paketën e Maleve në bashkinë tuaj?
 - Numri i kërkesave të mbërritura nga qytetarët është 40(dyzet).
4. - Sa është numri i kërkesave të mbërritura nga bizneset për të shprehur interes për identifikimin e zonave zhvillimore për Paketën e Maleve në bashkinë tuaj?
 - Numri i kërkesave të mbërritura nga bizneset është 0 (zero).
5. - Si është ndarja e këtyre kërkesave, sipas llojit të zhvillimit (agroturizëm, energji e gjelbër, blegtori, projekt social)? Ju lutem, të më vendoset në dispozicion ndarja e plotë, sipas numrit të kërkesave të paraqitura.
 - Ndarja e tyre është: Agroturizëm-25; energji e gjelbër-4; blegtori-6; tjetër-5

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI
Rrok DOHAJ



Adresa: Bashkia Pukë, sheshi "Gjergj Kastrioti (Skenderbeu)", e-mail: bashkiapuke@yahoo.com, faqe zyrtare www.bashkiapuke.gov.al

- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al*
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.